



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik “Zenel Zhabari B.I.” të datës 13.05.2025 kundër njoftimit mbi vendimin e datës 08.05.2025 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Trajtimi i qeneve endacak - Ritender” me nr. të prokurimit 616-25-2259-2-2-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik “Zenel Zhabari B.I.” të datës 13.05.2025 kundër njoftimit mbi vendimin e datës 08.05.2025 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Trajtimi i qeneve endacak - Ritender” me nr. të prokurimit 616-25-2259-2-2-1.
- II. **AUTORIZOHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të përcaktuar si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik “Zenel Zhabari B.I.” (tutje “parashtruesi”) me datë 13.05.2025 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin e datës 08.05.2025 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Trajtimi i qeneve endacak - Ritender” me nr. të prokurimit 616-25-2259-2-2-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet ankimore të parashtruesit:

P.1.-“ Mospërputhje ndërmjet çmimit me dhe pa TVSH”.

P.2.-“ Mospërmbushje e kërkesave teknike të detyrueshme – mungesë e deklaratës për mjetet për kapjen e qenve”.

Lidhur me pretendimin ankimor nr. 1, komisioni vlerësues ka siguruar dëshmi nga ATK ku konfirmohet se shërbimet veterinarike të cilat ofrohen nga tenderuesi i rekomanduar, janë të liruara nga TVSH. Në rastin konkret nuk është kontestues fakti që “trajtimi i qenëve endacak” është shërbim që listohen në këtë kategori. Rrjedhimisht çmimi me të cilin ka ofertuar është çmimi total dhe si i tillë ky çmim lirohet nga TVSH. Prandaj pretendimi është i pabazuar.

Lidhur me pretendimin ankimor nr. 2, është gjetur se tenderuesi i rekomanduar e ka dorëzua deklaratën për përmbushjen e specifikave teknike të detyrueshme në përputhje të plotë me aneksin 1, saktësisht sikurse është kërkuar me DT. Prandaj edhe ky pretendim ankimor është i pabazuar.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nënparagrafin b) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nënparagrafin d) të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 19.05.2025

Visar SHEHU

Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.